

Për raportin e veprimtarisë së SHBSH-së 2009

Synimi i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë gjatë vitit 2009 ka qenë përmbushja e misionit të saj:

“SHBSH ka si qëllim të kontribuojë për mbrojtjen e interesave të përbashkëta të njësive të vetëqeverisjes vendore të qyteteve, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratike në organizimin dhe funksionimin e bashkive dhe zbatimin e parimeve të Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale”.

Për të realizuar këtë mision, Shoqata ka përqendruar aktivitetin e vet në disa drejtime kryesore:

- Nxitja e praktikave më të mira në qeverisjen vendore
- Njohja me problematikën që shtrun integrimi në BE për qeverisjen vendore
- Trajtimi i problemeve të pushtetit vendor në seminare e trajnime me specialistë të bashkive
- Projektet për qeverisjen vendore
- Pjesëmarrje në veprimtaritë ndërkombëtare për qeverisjen vendore
- Botime për pushtetin vendor

Shoqata e Bashkive ka punuar me përkushtim në këto drejtime.

■ *Praktikat më të mira në qeverisjen vendore*

Është një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë së SHBSH-së shkëmbimi i praktikave më të mira në qeverisjen vendore. Kjo është realizuar përmes seminareve për fusha të caktuara, duke kulmuar me konferencën për “Praktikat më të Mira në Qeverisjen vendore mbajtur në muajin shtator në bashkëpunim me programin e qeverisjes vendore LGPA/USAID. Në të morën pjesë përfaqësues të bashkive të Shqipërisë, përfaqësues të OJF-ve që punojnë në fushën e qeverisjes vendore, përfaqësues të Parlamentit e Qeverisë.

E rëndësishme në këtë konferencë ishte pjesëmarrja dhe përshëndetja e Presidentit të Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi, i cili vlerësoi dobënë konferencës dhe arritjet e Shqipërisë në fushën e decentralizimit, duke nënvizuar njëkohësisht bashkëpunimin e të dy niveleve të pushtetit në shërbim të qytetarëve.

Gjatë dy ditëve të Konferencës u bënë prezantime, komente e diskutime në disa panele. Pjesëmarrësit shtjelluan çështje të rëndësishme si tendencat në të ardhurat vendore, planifikimin urban, menaxhimin e pronave, partneritetin publik privat, etj.

Përvoja e bashkisë Kukës me “Studimin e fizibilitetit për ndërtimin e një qendre biznesi” “Programi i partneritetit Publik-Privat (PPP)” i prezantuar në konferencë nga bashkia Korçë, “Zbatimi i planit rregullues urban me anë të nxitjes së zhvillimit të Zonës së Parkut” në bashkinë Fier përcolli te pjesëmarrësit e interesuar për qeverisjen vendore kreativitet dhe pjesëmarrje të komunitetit në zhvillimin e qytetit, apo “Financimi i një segmenti të unazës së qytetit me anë të huasë tregtare” të realizuar dhe shpjeguar nga

Bashkia e Fushë Krujës zgjoi interesimin e publikut për kurajën dhe profesionalizmin në kryerjen e punëve në shërbim të komunitetit.

Këto dhe praktika të tjera të transmetuara në këtë konferencë nga diskutantët e kualifikuar, krahas shkëmbimit të përvojave prodhuan edhe një sërë rekomandimesh për hapa të mëtejshëm që duhet të ndërmarrin njësitë e pushtetit vendor në të ardhmen.

E veçanta e kësaj konference ishte ekspozita e veprimtarive të 24 bashkive të paraqitura në stendat përkatëse ku evidentoheshin praktikat më të mira. Rastet studimore të përzgjedhura të praktikave më të mira janë përfshirë në një botim të Praktikave më të Mira të Bashkive 2009 dhe përfaqësojnë një shembull të vogël të përfaqësive novatore që përdoren nga njësitë e pushtetit vendor për të përmirësuar cilësinë e jetës. Ky botim u është shpërndarë bashkive por ofrohet edhe në faqen e internetit të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (www.aam-al.com) dhe të Programit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri.

■ *Njohja me problematikën që shtron integrimi në BE për qeverisjen vendore*

Gjithnjë e më tepër po i jepet rëndësi prezantimit të problemeve që lidhen me detyrimet e drejtat që bashkitë shqiptare gëzojnë me qenien vend kandidat për anëtarësim në BE.

Fushat e trajtuara në një seminar të veçantë kualifikimi në muajin maj me përfaqësues të Bashkive dhe punonjës të SHBSH-së për përvojat e qeverisjes vendore me Bashkimin Evropian kanë qenë shumë të frutshme për pjesëmarrësit për t'i përcjellë më tej në punën e përditshme në bashkitë përkatëse. Ekspertët nga Austria dhe Letonia treguan se problemet e qeverisjes vendore; si shërbimet e prokurimet publike, mjededit, mbetjet urbane, efica e energjisë, politikat sociale e rajonale, mbrojtja e konsumatorit, liria e lëvizjes, marrin një ngjyrim tjetër në kuadrin e vendit kandidat për anëtar i BE-së. Ata theksuan se edhe metodat e bashkëpunimit midis bashkive të vendit me ato të Evropës ndryshojnë tashmë. Duke dhënë përvojat e vendeve të tyre gjatë këtij procesi ata sugjeruan mënyra bashkëpunimi midis bashkive tona dhe atyre të vendeve të BE-së.

Në ndihmë të bashkive për këtë drejtim vjen edhe Gazeta e Bashkive e cila në faqen e parë të gazetës së prillit paraqet lajmin se “Njësitë vendore shqiptare mund të aplikojnë për të marrë fonde nga BE për binjakëzimin e qyteteve”. Po për këtë qëllim, në gazetën e nëntorit është botuar Deklarata e mbledhjes së Asamblesë së NALAS-it “Mbi përfshirjen aktive të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore në proceset e Integritimit në BE”, e cila ngarkon bashkitë por edhe qeveritë e vendeve përkatëse me një sërë detyrimesh për përfshirjen e njësie vendore në negociatat për integrim në BE pasi 70% e legjislacionit të BE-së është për pushtetin vendor ndaj ai duhet të jetë zë i fuqishëm në këto negociata. Këto bëhen me synim që bashkitë të mësojnë se kanë mundësi të aplikojnë për fonde projektesh në kuadër të binjakëzimit me bashki të vendeve të BE-së.

Nga ana tjetër njësitë vendore duhet të kualifikojnë specialistë për problemet e BE-së dhe qeverisjes vendore për të njohur detyrimet dhe të drejtat që lindin nga ky integrim. Si fillim aplikimi për fonde të BE-së me binjakëzim apo përmes shoqatës së bashkive duhet të fillojë të aplikohet nga njësitë vendore.

Roli i shoqatës po bëhet përherë e më i ndjeshëm në këtë drejtim, me kualifikim të stafëve të bashkive, botime, mbështetje për të gjetur partnerë për të aplikuar për fonde të BE-së.

Kjo do të përbëjë një drejtim të rëndësishëm të SHBSH-së në të ardhmen.

■ **Trajtimi i problemeve të pushtetit vendor në seminare e trajnime me specialistë të bashkive**

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka organizuar një sërë seminaresh e trajnimesh gjatë vitit 2009 për probleme të qeverisjes vendore bazuar në nevojat e bashkive. Në këto seminare specialistët e bashkive kanë këmbyer përvojat e ngritur probleme që kërkojnë zgjidhje nga qeveria qendrore, si dhe kanë sugjeruar programe bashkëpunimi midis bashkive për probleme të veçanta. Seminaret e zhvilluara kanë qenë me tematika të ndryshme në përgjigje të nevojave të bashkive dhe kanë sugjeruar rekomandime të vlefshme për mbarëvajtjen e punëve në bashki. Po rreshtojmë seminaret e zhvilluara me rekomandimet përkatëse:

- Seminari **“Prokurimi publik në nivel vendor”** rekomandon:
 1. *Nevojën për intensifikimin e trajnimit për prokurimin elektronik dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e kësaj mënyre të prokurimit*
 2. *Të nxiten modelet e bashkëpunimit ndër komunal të bashkive më të vogla me bashkitë që janë më të përparuara në drejtim të prokurimit elektronik, për të arritur drejt kryerjes së prokurimit të përbashkët, me kosto më të ulët dhe më eficiente,*
 3. *Të zhvillohen trajnime specifike në drejtim të procedurës për kontratat e konsulencës si një procedurë shumë specifike me impakt në sigurimin e konsulencës intelektuale për pushtetin vendor (studime urbanistike; hartim projektesh etj.),*
 4. *Për të siguruar trajnim të vazhdueshëm, jo vetëm për prokurimin publik, Shoqata duhet të zhvillojë projekte në drejtim të hapjes së portalit online të trajnimit dhe asistencës ndaj bashkive.*

- Seminari **me kryetarët e këshillave bashkiake** sugjeron:
 1. *Në lidhje me “problemet e buxhetit”, që vetë këshilli të ketë fondet e veta për t’i përdorur për përmirësimin e veprimtarisë së tij, sidomos në drejtim të studimeve dhe, më drejtpërdrejtë, për trajnime dhe shkëmbim përvoje.*
 2. *Përsa i takon çështjes së “Pronave publike vendore”, duhet intensifikuar puna në procesin e transferimit të pronave nga pushteti qendror. Në këtë drejtim, këshilli i bashkisë ka rol të veçantë në vendimet që duhet të marrë për të realizuar një administrim sa më të mirë të pronave publike vendore.*

- **Probleme për taksat vendore,**

Shoqata ka zhvilluar 5 takime zonale me drejtues e specialistë të strukturave administrative të taksave vendore nga të gjitha bashkitë e vendit në datat 24-31 mars 2009. Këto takime u realizuan në bashkëpunim me Ministrinë e Financave në Elbasan, Shkodër, Tiranë, Vlorë e Gjirokastrë. Në të gjitha takimet u theksua se **transferimi i taksave në njësitë e QV ka sjellë përmirësime të ndjeshme në rritjen e të ardhurave dhe në uljen e evazionit fiskal**. U ngritën disa probleme për tu zgjidhur:

1. *Bashkitë kërkojnë aplikimin e rregullt të taksës së kalimit së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, pasi ka paqartësi,*
2. *Zyrat e regjistrimit të pasurive të japin informacion për ndryshimet në pronësi e për bizneset e reja,*
3. *Krijimi i QKR mbështetet nga bashkitë por ato duhet të komunikojnë më mirë me bashkitë.*

➤ **Arsimi parauniversitar, decentralizimi dhe roli i bashkive,**

1. *Po ashtu u trajtua nevoja e përmirësimit të punës për krijimin e mjediseve sa më të mira të shkollës duke e lidhur këtë me*
 - *nevojën për rritjen e fondeve*
 - *nevojën e institucionalizimit të standardeve dhe që ato të shërbejnë si bazë për financimin nga buxheti i shtetit apo për mobilizimin e fondeve nga vetë bashkitë.*
2. *Nevoja e hartimit nga ana e bashkive të programeve të veçanta për zhvillimin e arsimit, organizimi dhe planifikimi i punës për mirë përdorimin e çdo objekti shkollor,*
3. *Përgjegjësitë, kompetencat dhe vendosja e raporteve të sakta midis strukturave të pushtetit qendror dhe atij vendor të rregullohen me ligje dhe akte nënligjore në zbatim të tyre, pasi legjislacioni aktual nuk përputhet me reformën e decentralizimit dhe përcaktimet e bëra nga ligji i qeverisjes vendore në këtë drejtim.*

➤ **Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe pushteti vendor,**

Seminari për menaxhimin e mbetjeve urbane u zhvillua në bashkëpunim me REC e Coplan. Morën pjesë kryetarë bashkie, specialistë të mjedisit në bashki, përfaqësues të shoqatave që merren me problemet e mjedisit. Ishte një seminar i dobishëm dhe i vlerësuar nga pjesëmarrësit për informacionin që përcolli. U sugjerua që të tilla të zhvillohen edhe në nivel rajoni dhe me kohëzgjatje më të madhe që të kenë mundësi pjesëmarrësit të ndajnë përvojat dhe të jenë me tematikë më specifike sipas problemeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve.

➤ **Për policinë bashkiake,**

Takimi me përfaqësues të bashkive me temë “Policia bashkiake dhe bashkërendimi i punës së saj me strukturat e tjera brenda dhe jashtë bashkisë” u zhvillua në Durrës në datat 26 dhe 28 maj 2009. Në këto takime morën pjesë rreth 45 drejtues të policisë të bashkive të vendit, sipas një ndarjeje të tyre në bashki më të vogla në ditën e parë dhe bashki më të mëdha në ditën e dytë.

Takimet kishin si qëllim:

- Shkëmbimin e përvojave midis bashkive në veprimtarinë e tyre në ushtrim të kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar.
- Evidentimin e problemeve dhe të shihet mundësia e bashkërendimit të punës për të arritur në përfundime për të propozuar ndryshime në dokumentacionin ligjor për këtë sektor.

➤ ***Krijimi i kapaciteteve në pushtetin vendor për zbatimin e ligjit të huamarrjes dhe administrimin e taksave lokale***

?????

➤ ***Përvojat e Shoqatave të Qeverisjes Vendore me Bashkimin Evropian***

Një seminar trajnimi u zhvillua në datat 21-22 maj nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë për ngritjen e kapaciteteve të Shoqatës me njohuri në fushën e legjislacionit të BE-së, përvojave të vendeve anëtare të BE-së në aspektin e qeverisjes vendore. Në seminar morën pjesë punonjës të shoqatës dhe përfaqësues të disa bashkive si Tirana, Lezha, Kuçova, Rrësheni, Kamza, Kukësi, etj. Seminari u zhvillua në gjuhën angleze pasi të dy ekspertët ishin të huaj dhe pjesëmarrësit u përzgjodhën me këtë kriter.

Seminari ishte i dobishëm jo vetëm për informacionin në lidhje me strukturat e BE-së dhe legjislacionin e saj, por për përvojat konkrete që përcollën ekspertët nisur nga vendet e tyre. Është shumë e nevojshme që seminare të tilla të zhvillohen në nivel bashkie pasi gjithnjë e më tepër këto probleme do të jenë pjesë e veprimtarisë së qeverisjes vendore në kuadrin e hyrjes në BE dhe të drejtës që u njihet njërive vendore për të konkurruar për fondet e BE-së përmes SHBSH-së që është anëtare e CEMR. *(Më hollësisht për këtë seminar flitet në gazetën e bashkive nr.19)*

➤ ***Takime me përfaqësues të bashkive për Regjistrin e Planifikimit të territorit***

Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Programit Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2) dhe Shoqatës së Bashkive dhe me mbështetjen e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit u organizua një seminar konsultimi në Bashkitë Shkodër, Fier, Tiranë e Vlorë për reformën në planifikimin e territorit.

Këto seminare janë pjesë e konsultimeve me partnerët lokalë në pesë bashkitë me asistencën e programit MCCA2, që do të zbatojnë qasjen nëpërmjet internetit në informacion për planifikimin e territorit, si dhe mundësinë e ndjekjes po përmes internetit të ecurisë së procesit të lejeve të ndërtimit.

Faza e dytë e programit “Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit Shqipëri” është një marrëveshje dyvjeçare me vlerë 15.7 milion dollarë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e financuar nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) dhe e administruar nga USAID, e cila ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar klimën për biznes në Shqipëri.

➤ ***Për hartimin e buxheteve vendore 2010 dhe ndryshimet e legjislacionit***

Gjatë muajve nëntor – dhjetor, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Hanns Seidel dhe mbështetjen e USAID ka organizuar 5 takime në nivel rajonal me bashkitë për hartimin e buxheteve lokale dhe ndryshimeve ligjore për pushtetin vendor të bëra nga parlamenti gjatë këtij viti. Këto takime u zhvilluan në qytetet e Lezhës, Vlorës, Elbasanit, Sarandës e Durrësit.

Sugjerimet e dhëna në këto takime ishin shumë të vlefshme jo vetëm për përmirësimin e punës së bashkive por edhe për vetë ecurinë e veprimtarisë së shoqatës në mbrojtje të interesave të bashkive. Të gjitha konkluzionet e sugjerimet e mbledhjeve ju përcollën ministrit të Financave duke ia bërë të njohura tërë kryetarëve të bashkive.

➤ ***Takime të Forumit të juristëve të bashkive për probleme të zbatimit të ligjit në qeverisjen vendore***

Gjatë vitit 2009 janë organizuar dy mbledhje të forumit të juristëve në mars dhe shtator. Në këto takime krahas diskutimit për probleme ligjore që hasin juristët e bashkive gjatë punës së tyre është diskutuar edhe për probleme të veçanta si “konflikti i interesit” apo ligjet e reja të hartuara apo ndryshuara për qeverisjen vendore.

Në mbledhjen e shtatorit janë ndalur veçanërisht në Ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 mbi “Planifikimin e Territorit” dhe ligjin nr. 10112, datë 09.04.2009 për “Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” për diskutimin rreth të cilëve janë ftuar të japin mendime ekspertë të fushës.

Nga këto mbledhje janë formuluar konkluzione e sugjerime që u janë përcjellë institucioneve përkatëse qendrore e vendore për t’i marrë në konsideratë.

➤ ***Për marrëdhëniet me publikun,***

Një takim i dobishëm u zhvillua në Shoqatën e Bashkive me punonjës të marrëdhënieve me publikun në bashki të ndryshme më datë 20 janar 2009. Synimi ishte këmbimi i përvojave dhe vlerësimi i nevojave që kanë bashkitë në fushën e marrëdhënieve me publikun. Fillimisht takimi u përqendrua në detyrat që mbulon zyra e marrëdhënieve me publikun në bashki. Pjesëmarrësit sollën përvojat përkatëse duke këmbyer mendimet mbi mënyrën e informimit të qytetarëve, mbledhjes së kërkesave të tyre dhe përcjellja e kërkesës deri në momentin e zgjidhjes e dhënies së përgjigjes. Secila bashki kishte përvojë të veçantë por dhe shumë të përbashkëta në zhvillimin e kësaj veprimtarie të lidhur drejtpërdrejt me qytetarët.

Drejtim tjetër i diskutimit ishte faqja e internetit të bashkisë si një risi e domosdoshme e kohës. Deri tani numërohen rreth 16 bashki në 65 që kanë faqe interneti. Disa syresh mjaft të lavdëruara në këtë fushë si Vlora me paraqitjen e problematikës e përditësimin, Kukësi me transparencën e bashkisë, dhe Rrësheni me thjeshtësinë e dëshirën e bukur për punë të mira.

Botimet e bashkive ishin një drejtim tjetër i diskutimit ku Berati prezantoi botime të arrira për qytetin e vet monument kulture i UNESCO-s.

Është edhe kjo një fushë e gjerë diskutimi që kërkon hapësirë ndaj u sugjerua një seminar tjetër të zhvillohet për punonjësit e marrëdhënieve me publikun ku të diskutohet për të gjithë gamën e çështjeve që ata mbulojnë në bashki .

➤ *Seminar kualifikimi profesional me sekretaret e kryetarëve të bashkive*

Duke vlerësuar rëndësinë e punës së sekretares/it të kryetarit si ndihmës në kryerjen e funksionit qeverisës të kryetarit të bashkisë në shërbim të komunitetit, SBSH organizoi një seminar me sekretarët e kryetarëve të bashkive më 19-20 shkurt, ku morën pjesë 37 pjesëmarrës. Në këtë seminar drejtuan debatin dhe dhanë informacion të dobishëm ekspertë të kualifikuar dhe me përvojë në fushë.

Qëllimi i tij ishte që përmes debatit midis ekspertëve dhe pjesëmarrësve, të trajtoheshin drejtimit kryesorë të punës së sekretares/it të kryetarit të bashkisë. Ndër problemet e trajtuara në këtë seminar janë:

- *Marrëdhëniet e sekretarit me publikun dhe median si komunikim me publikun,*
- *Protokolli në administratë.*
- *Sekretari/ja e Kryetarit në lidhje me ushtrimimin e funksioneve dhe kompetencave të caktuara me ligj për kryetarin e bashkisë.*
- *Përmbajtja e faqes në internet të Shoqatës së Bashkive u shpjegua me qëllim që të prezantohej faqja e grupit të krijuar në adresën e Facebook në emër të shoqatës, ideja e përfshirjes dhe përdorimit të komunikimit në mënyrë elektronike, midis të gjitha bashkive dhe shoqatës.*

Ky trajnim u vlerësua prej sekretareve dhe madje u kërkua që takime të tilla të zhvillohen më shpesh

Seminaret me tematikat e lartpërmendura janë kryer në disa rajone duke mbledhur në një qytet përfaqësues të disa bashkive si në Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Tepelenë, Sarandë. Duhet theksuar se për realizimin e tyre ka mbështetur financiarisht Fondacioni “Hanns Seidel”, të cilin e falënderojmë për mbështetjen e dhënë sidomos në drejtim të trajnimeve.

Në këto seminare kanë dalë një sërë problemesh dhe janë ngritur shqetësimet e pjesëmarrësve në lidhje me përvojën e përditshme në sektorët përkatës. Do të rendisim sipas tematikës disa prej shqetësimeve kryesore të ngritura prej pjesëmarrësve në seminare të përkatëse:

■ **Projektet për qeverisjen vendore**

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka zbatuar disa projekte gjatë vitit 2009. Një pjesë e tyre janë zhvilluar drejtpërdrejt nga SHBSH në të tjera ka qenë në partneritet me organizata të tjera që punojnë në fushën e qeverisjes vendore.

i. Projekti për Konfliktin e interesit

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me mbështetjen e USAID hartoi një manual mbi parandalimin e konfliktit të interesit në nivel vendor. Qëllimi i hartimit të këtij manuali qe trajtimi i *Konfliktit të Interesit* në nivel vendor, trajnimi i nëpunësve vendorë në lidhje me konfliktin e interesit në mënyrë që të shmangen dhe parandalohen pasojat që

derivojnë nga ky konflikt. Manuali i botuar u është shpërndarë gjithë bashkive të vendit dhe aktorëve të tjerë të interesuar për në veprimtaritë që SHBSH ka zhvilluar gjatë vitit 2009.

ii. Projekti për Integrimin Urban të Zonave Informale

Projekti pilot “Integrimi urban i ndërtimeve pa leje në bashkinë Sukth”, i filluar në shtator 2008 në kuadrin e projekteve të aplikuara nga NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Bashkive të Vendeve të Evropës Juglindore) në rajon dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, ka vazhduar dhe gjatë vitit 2009 dhe ka si objektiv kryesor mbështetjen për hartimin përfundimtar të planit urban të Bashkisë Sukth.

iii. Projekti për përmirësimin e shërbimeve publike në nivel vendor

Ky projekt u mbyll në mars prill 2009 me një konferencë kombëtare organizuar nga SHBSH në kuadrin e projektit.

iv. Projekti LOGIN www.logincee.org

LOGIN është rrjeti informativ i qeverisjes vendore i krijuar për të nxitur dhe promovuar zhvillimin profesional të zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe stafit të tyre. LOGIN lehtëson shkëmbimin e informacionit nëpërmjet internetit dhe metodave tradicionale si: seminare, botime, konferenca, trajnime, etj. Shoqata e Bashkive në bashkëpunim me Co-Plan, kanë filluar zbatimin e këtij projekti duke vendosur materiale në faqen e internetit të LOGIN-it mjaft te domosdoshme ne fushën e pushtetit vendor. Gjithashtu në faqen e shoqatës www.aam-al.com është vendosur një link me emrin login ku të gjithë aktorët e interesuar mund të klikojnë dhe të shohin direkt faqen e LOGIN-it.

v. Barazi gjinore në qeverisjen vendore

Në bashkëpunim me programin EiG, të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Austrisë dhe zbatuar nga Drejtoria e Shanseve të Barabarta në MPCSSHB, SHBSH ishte palë në një seminar me personat e kontaktit për barazinë gjinore në bashki. Ky seminar u zhvillua në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore që ngarkon të gjitha njësitë vendore të ndjekin problemet gjinore duke emëruar persona përgjegjës për këto problem të cilët do të ndikojnë në eliminimin e diskriminimeve gjinore dhe nxitjen e barazisë mes dy gjinive përmes programeve e projekteve të posaçme në këtë fushë.

vi. Projekt me Intercooperation Shqipëri

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka një bashkëpunim të mirë me IC Intercooperation. Jemi financuar për organizimin e nje seminari per prokurimet publike, vazhdon financimi i Gazetës së Bashkive për një vit sipas projektit, dhe është financuar udhëtimi studimor në Poloni për disa kryetarë bashkie të qarkut Shkodër. Përfaqësuesi i SHBSH merr pjesë në mbledhjen tremujore të IC Intercooperation me prezantime sipas tematikës së miratuar.

■ **Pjesëmarrje në veprimtaritë ndërkombëtare për qeverisjen vendore**

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë gjatë vitit 2009 ka qenë mjaft aktive dhe e dukshme në veprimtaritë ndërkombëtare.

Bëjmë me dije se kryetari i SHBSH-së, Z. Refik Rugeja u zgjodh Raporter i Përgjithshëm I Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për Demokracinë Lokale dhe Rajonale në Evropën Juglindore në qershor 2009.

Më parë në prill 2009, z. Rugeja foli në Asamblenë e Përgjithshme të CEMR (Shoqata e Shoqatave Vendore të Evropës) në emër të Rrjetit të Shoqatave Vendore të Evropës Juglindore (NALAS).

Ndërsa në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit të Shoqatave Vendore të Evropës Juglindore (NALAS) të mbajtur më 10-11 dhjetor 2009 në Stamboll, u zgjodh zëvendës-president i NALAS-it.

NALAS (*Rrjeti i Shoqatave Vendore të Evropës Juglindore*)

Duke qenë një nga anëtarët themelues të rrjetit të NALAS-it, Shoqata ka marrë pjesë rregullisht në takimet e rrjetit duke ndikuar në rritjen e bashkëpunimit me të gjitha Shoqatat homologe të Ballkanit por edhe në zhvillimin e kapaciteteve të personelit të saj.

Përfaqësues të SHBSH-së marrin pjesë aktive në Task forcat e fushave të ndryshme të NALAS-it.

Kongresi

NALAS

Veprimtaritë ndërkufitare për bashkëpunimin ndërbashkiak

CEMR (Këshilli Evropian i Bashkive dhe Komunave)

Shoqata është anëtarësuar edhe në CEMR, që është një nga organizatat me zë të fuqishëm në politikën evropiane kryesisht në nivelin e BE-së. Në kuadrin e integritimit në BE, SHBSH po nxit një politikë përfshirëse për njësitë vendore në grupet e punës për integrimin.

■ Botime për pushtetin vendor

Viti 2009 ka qenë i pasur me botime të prodhuara nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë. Do të vinim në krye të tyre botimin e fundit:

- “Qeverisja Vendore në Shqipëri”, financuar nga Fondacioni Hanns Seidel
- “Manual mbi parandalimin e konfliktit të interesave në pushtetin vendor”, në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive financuar nga USAID,

✚ “Praktikat më të mira të Qeverisjes Vendore”, bashkëpunim me LGPA/USAID, e Universiteti Polis,

Shoqata kanë qenë bashkëpunëtore në botime të tjera për qeverisjen vendore si Manual për Këshilltarët, apo Udhëzuesin për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Ka vazhduar edhe gjatë vitit 2009 botimi i *Gazetës së Bashkive*, e cila është konsoliduar më tej duke përcjellë tek lexuesi përvojat më të mira të qeverisjes vendore nga vendi, rajoni e bota. Ajo ka shërbyer për të njohur aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e qeverisjes vendore me veprimtarinë e Shoqatës së bashkive dhe problemet që shqetësojnë pushtetin vendor. Gazeta ka përcjellë në kohë të lexuesi përfaqësimin dhe vlerësimin për SHBSH-në në organizatat e tjera të qeverisjes vendore në nivel rajonal e evropian.

Shoqata e bashkive është një institucion demokratik dhe një katalizator i procesit të decentralizimit. Prandaj është detyrë e të gjithë të zgjedhurve vendorë dhe administratave të tyre për ta forcuar dhe fuqizuar sepse së bashku jemi më të fortë. Sepse së bashku dimë më shumë sepse së bashku do t’i kalojmë vështirësitë më lehtë.

Janar 2010